



REPUBLIKA E KOSOVËS
ZYRA E AUDITORIT TË PËRGJITHSHËM

Nr. i Dokumentit: 24.27.1-2014-08

RAPORTI I AUDITIMIT
PËR PASQYRAT FINANCIARE TË INSTITUCIONIT TË AVOKATIT TË
POPULLIT PËR VITIN E PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2014

Prishtinë, Qershor 2015

Zyra e Auditorit të Përgjithshëm kryen auditime të rregullsisë dhe të performancës. Auditori i Përgjithshëm në Detyrë është kreu i Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm, i cili ka rreth 145 të punësuar. Auditori i Përgjithshëm dhe Zyra e Auditorit të Përgjithshëm janë të pavarur dhe çertifikon rreth 90 Pasqyra Vjetore Financiare çdo vit, derisa ndërmarrin edhe forma të tjera të auditimit.

Misioni ynë është që të kontribuojmë në menaxhim të shëndoshë financiar në administratë publike. Ne do të kryejmë auditime cilësore në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtare të auditimit në sektorin publik dhe praktikatat e mira evropiane. Ne do të ndërtojmë besim në shpenzimin e fondeve publike. Ne do të luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe palëve tjerë të interesit në rritjen e llogaridhënies publike.

Raportet e nxjerra nga Zyra e Auditorit të Përgjithshëm promovojnë drejtpërsëdrejti llogaridhënien pasi që ato ofrojnë bazë për ti kërkuar llogari menaxherëve të çdo organizate buxhetore.

Auditori i Përgjithshëm në Detyrë ka vendosur në lidhje me opinionin e auditimit dhe raportin mbi Pasqyrat Vjetore Financiare të Institucionit të Avokatit të Popullit në konsultim me Ndihmës Auditorin e Përgjithshëm, Ibrahim Gjylderen, i cili e ka mbikëqyrur auditimin.

Raporti dhe opinionin i lëshuar janë rezultat i auditimit të kryer nën menaxhimin e Drejtorit të Auditimit, Valbon Bytyqi, i mbështetur nga Agron Fetiu (Udhëheqës Ekipi) dhe Leonora Hasani (Anëtare e ekipit).

TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme	4
1 Fushëveprimi i auditimit dhe metodologjia	6
2 Pasqyrat vjetore financiare dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm	8
3 Rekomandimet e vitit paraprak	10
4 Qeverisja	11
Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZAP	19
Shtojca II: Rekomandimet e vitit paraprak	22


Përmbledhje e përgjithshme

Hyrje

Ky raport përmbledh çështjet kryesore që dalin nga auditimi ynë i pasqyrave vjetore financiare të Institucionit të Avokatit të Popullit për vitin 2014 - i cili e përcakton Opinionin e dhënë nga Auditori i Përgjithshëm. Falënderojmë Avokatin e Popullit, Drejtorin e Ekzekutiv dhe stafin e tyre për ndihmën e tyre gjatë procesit të auditimit.

Ekzaminimi i pasqyrave financiare për vitin 2014 u ndërmor në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtarisht të auditimit në Sektorit Publik (SNISA). Qasja jonë ka përfshirë testet dhe procedurat, të cilat ne menduam se ishin të nevojshme për të arritur në një opinion lidhur me pasqyrat financiare. Qasja e ndërmarrë është paraqitur në Memon e Planifikimit të Auditimit, e datës 08.10.2014.

Auditimi ynë është fokusuar në:



Niveli i punës së kryer nga Zyra e Auditorit të Përgjithshëm për të përfunduar auditimin për vitin 2014 pasqyron drejtpërsëdrejti cilësinë e kontrollit të brendshëm të zbatuar nga menaxhmenti.

Opinion


Shtojca I shpjegon llojet e ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ana e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm.

Sipas opinionit tonë pasqyrat financiare prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale (**SNISAI 200/1700 Opinion i Pamodifikuar**).

Konkluzioni i përgjithshëm

IAP ka zbatuar një sërë kontrollesh të brendshme për të siguruar se sistemet financiare funksionojnë siç duhet. Ne arritëm të marrim siguri nga kontrollet efektive të menaxhmentit në një pjesë të fushave të prezantuara në PVF.

Mirëpo, edhe përpos progresit mbetet hapësirë për përmirësim. Konkluzionet dhe rekomandimet tona kryesore janë:



Përgjigja e Menaxhmentit – auditimi 2014

Të gjeturat e detajuara dhe konkluzionet e auditimit në këtë raport janë marrë në konsideratë nga Menaxhmenti.

1 Fushëveprimi i auditimit dhe metodologjia

Është përgjegjësi e Institucionit të Avokatit të Popullit (IAP) të përgatisë Pasqyrat Vjetore Financiare (PVF) sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik (SNKSP) për “Raportimin Financiar në bazë të Kontabilitetit të Parasë së Gatshme” dhe kërkesave të tjera specifike. Zyra e Auditorit të Përgjithshëm (ZAP) është përgjegjëse për kryerjen e auditimit të rregullsisë që përfshin ekzaminimin dhe vlerësimin e pasqyrave financiare dhe të dhënave tjera financiare si dhe të shprehemi:

- nëse PVF japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të llogarive dhe çështjeve financiare për periudhën e auditimit;
- nëse të dhënat financiare, sistemet dhe transaksionet janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi;
- për përshtatshmërinë e funksioneve të kontrollit të brendshëm dhe të auditimit të brendshëm; dhe
- për të gjitha çështjet të cilat dalin apo kanë të bëjnë me auditimin.

Ne kemi shqyrtuar kontrollet menaxheriale për të përcaktuar shkallën deri ku mund të mbështetemi në to për përcaktimin e testimit të hollësishëm, i cili është i nevojshëm për të siguruar nivelin e nevojshëm të dëshmimeve, për të mbështetur opinionin e Auditorit të Përgjithshëm (AP). Aktivitetet e menaxhmentit përcaktojnë edhe fokusin e auditimit tonë të pajtueshmërisë dhe auditimit të qeverisjes së mirë të cilat nuk kanë ndikim të drejtpërdrejtë në opinion.

Qasja jonë audituese ndaj qeverisjes fokusohet në vlerësimin e veprimeve të ndërmarra nga menaxhmenti me qëllimin për të siguruar menaxhim financiar dhe kontroll efektiv si dhe në vlerësimin e rezultateve të këtyre veprimeve në dhënien në mënyrë efikase të produkteve operative cilësore. Për sistemet individuale financiare, ne kërkojmë të identifikojmë nivelin në të cilin funksionojnë kontrollet aktuale. Shembull i një aktiviteti mund të jetë monitorimi i ndërmarrë nga menaxhmenti ose nga nivele më të ulëta të kontrolleve operative. Ne konsiderojmë nëse kontrollet janë të dizajnuara mirë, nëse janë implementuar sipas planit dhe nëse operojnë në mënyrë efektive. Për këtë nevojitet një vlerësim i strukturave, proceseve dhe linjave të llogaridhënies të prezantuara nga menaxhmenti, përfshirë këtu edhe rolin e Auditimit të Brendshëm dhe të Komitetit të Auditimit si dhe kontrollet e brendshme të sistemit.

Pjesët e mëposhtme ofrojnë një përmbledhje më të detajuar të të gjeturave tona të auditimit me theks të veçantë në vëzhgimet dhe rekomandimet në çdo fushë të rishikimit. Një vlerësim i mënyrës se si Menaxhmenti i ka adresuar rekomandimet e bëra në vitin 2013 mund të gjendet në Shtojcën II.

Për të qenë më i plotë, ne kemi përfshirë çështjet e identifikuar gjatë auditimit të ndërmjetëm aty ku ato kanë mbetur relevante. Në fazën e auditimit të ndërmjetëm ne ofrojmë këshilla me qëllim që të mundësojmë ndërmarrjen e veprimeve përkatëse para prodhimit të PVF-ve dhe para auditimit final.

Të gjeturat tona janë definuar si:

Të prioritetit të lartë - Çështje të cilat mund të rezultojnë në dobësi materiale në kontrollin e brendshëm dhe ku veprimi i marrë do të ofrojë mundësinë për përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të kontrolleve të brendshme; dhe

Të prioritetit të mesëm - Çështje të cilat mund të mos rezultojnë në dobësi materiale, por ku veprimi i marrë do të ofrojë mundësinë për përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të kontrolleve të brendshme.

Të gjeturat që konsiderohen me prioritet të ulët do të raportohen veçmas stafit të financave.

Procedurat tona kanë përfshirë një rishikim të kontrolleve të brendshme dhe sistemeve të kontabilitetit dhe teste substanciale të shoqëruara me to vetëm deri në atë masë që konsiderohet e nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Të gjeturat e auditimit nuk duhet të konsiderohen sikur përfaqësojnë një pasqyrë gjithëpërfshirëse të të gjitha dobësive që ekzistojnë, apo edhe të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që kanë funksionuar.

2 Pasqyrat vjetore financiare dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm

Përshkrimi

Rishikimi ynë i PVF-ve merr parasysh pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë dhe saktësinë e informacionit të regjistruar në pasqyrat financiare. Ne gjithashtu e marrim parasysh deklaratën e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ (ZKA) dhe Zyrtari Kryesor Financiar (ZKF), kur draft PVF-të, të dorëzohen në Qeveri.

Deklarata në lidhje me prezantimin e PVF-ve përfshin një numër të pohimeve për sa i përket pajtueshmërisë me kornizën raportuese dhe cilësisë së informacionit në kuadër të pasqyrave financiare. Disa deklarata kanë për qëllim t'i ofrojnë Qeverisë sigurinë se të gjitha informatat relevante janë ofruar për të siguruar se mund të ndërmerret një auditim gjithëpërfshirës.

Konkluzioni i përgjithshëm

IAP, ka arritur të dorëzoj me kohë të gjitha raportet të cilat kërkohen me kornizën e aplikueshme ligjore. PVF-të ishin të përgatitura në pajtim të plotë me kërkesat e SNKSP “Raportimi Financiar sipas Kontabilitetit të Parasë së Gatshme” dhe Rregullores MF – Nr. 03/2013.

2.1 Opinioni i Auditimit

Sipas opinionit tonë pasqyrat financiare prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale (**SNISAI 200/1700 Opinion i Pamodifikuar**).

2.2 Pajtueshmëria me PVF dhe kërkesat tjera për raportim

Përshkrimi

PVF-të e IAP-së, përfshirë edhe të gjitha kërkesat tjera për raportim duhet të jenë në përputhje me kornizën e caktuar raportuese dhe kërkesave të jashtme për raportim. Ne kemi marrë parasysh:

- Kërkesat e LMFP-së nr. 03/L-048 dhe ndryshim plotësimet e tij;
- Pajtueshmërinë me Rregullën MF - nr. 03/2013 për PVF-të e organizatave buxhetore;
- Kërkesat e rregullores nr. 01/2013/MF - Shpenzimi i parave publike;
- Kërkesat e rregullores MF-nr. 02/2013 për menaxhimin e pasurive jo financiare të organizatave buxhetore;
- Kërkesat nga rregulla financiare nr.02/2013/MF për raportimin e obligimeve të papaguara të organizatave buxhetore; dhe
- Kërkesat e procedurave të Menaxhimit Financiar dhe të Kontrolleve (MFK).

Në kontekst të PVF-ve dhe raportimit të jashtëm ne nuk kemi asnjë çështje për të ngritur.

Rekomandimi

Ne nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

3 Rekomandimet e vitit paraprak

Konkluzioni i përgjithshëm

Menaxhmenti nuk ka bërë monitorim të rregullt për adresimin e rekomandimeve. Si rrjedhojë pjesa më e madhe e tyre kishin mbetur të pa adresuara. Kjo ka ndikuar që problemet e njëjta të bartura nga vitet paraprake të jenë edhe më tutje prezente.

Përshkrimi

Raporti ynë i auditimit për PVF-të e IAP-së për vitin 2013 ka rezultuar me gjashtë rekomandime kryesore. IAP kishte përgatitur një plan veprimi ku paraqitet mënyra se si do të adresohen të gjitha rekomandimet.

Një prej tyre janë adresuar plotësisht, një pjesërisht dhe katër nuk janë adresuar ende. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrës se si janë adresuar ato, shihni Shtojcën II.

Çështja 1 - Nivel i ulët i adresimit të rekomandimeve - Prioritet i lartë

E gjetura IAP nuk e ka aplikuar një proces efektiv për të menaxhuar dhe monitoruar se si janë duke u adresuar rekomandimet e AP-së në pajtueshmëri me planin e përgatitur për veprim. Si rrjedhojë pjesa më e madhe e tyre ishin mbetur të pa adresuara.

Rreziku Dobësitë e vazhdueshme të kontrolleve të menaxhmentit dhe kontrolleve të tjera në sisteme kyçe financiare dhe të cilat nuk janë adresuar, kanë rezultuar në:

- Dobësi të vazhdueshme në ekzekutimin e buxhetit;
- Jo efikasitet në realizimin e prokurimeve; dhe
- Vonesat në ekzekutimin e pagesave ndaj Operatoreve Ekonomik (OE).

Rekomandimi 1 Avokati i Popullit duhet të sigurojë se plani i veprimit të rekomandimeve është duke u trajtuar nga personat përgjegjës, brenda afateve të përcaktuara kohore. Implementimi i këtij plani duhet të rishikohet nga menaxhmenti në baza të rregullta. Rendësi e veçantë duhet t'i kushtohet rekomandimeve të cilat janë duke u përsëritur në vazhdimësi nga vitet paraprake.

4 Qeverisja

Konkluzioni i përgjithshëm

Aspektet kyçe të kornizës së qeverisjes janë adresuar nga IAP si në vazhdim:

- Vetëvlerësimi – është kryer në përputhje me rregullat e MFK-së, duke i shërbyer si një pikënisje për të përmirësuar performancën e saj aty ku shihet e nevojshme;
- Menaxhimi i rrezikut – IAP nuk ka aprovuar/aplikuar ndonjë procedurë formale për identifikimin, vlerësimin dhe menaxhimin e rreziqeve operationale në nivel të organizatës. Mirëpo ata kanë bërë një vlerësim të rreziqeve përmes raportit vjetor dhe planit strategjik; dhe
- Raportimi i menaxhmentit – në baza të rregullta në të cilat është diskutuar në detaje menaxhimi i buxhetit dhe çështje tjera rreth aktiviteteve operative.

IAP ka zbatuar një sërë kontrollesh të brendshme për të siguruar se sistemet financiare funksionojnë siç duhet. Ne arritëm të marrim siguri nga kontrollet efektive të menaxhmentit në një pjesë të fushave të prezantuara në PVF.

Njësia e Auditimit të Brendshëm (NJAB) kishte realizuar disa raporte të auditimit për menaxhmentin. Ato ofruan një pasqyrë të qartë mbi nivelin e sigurisë së kontrolleve të brendshme dhe efektivitetin e tyre.

Mirëpo edhe përpos progresit, mbetën disa çështje për përmirësim. Realizimi i buxhetit gjatë vitit 2014, ishte i ulët, 79%, i cili ishte më i ulët për 3% krahasuar me vitin 2013.

Ndërsa nga aspekti i rëndësisë më të ulët kontrolle shtesë nevojiten te menaxhimi i prokurimit dhe te raportimi i obligimeve.

4.1 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit

Përshkrimi

Ne kemi shqyrtuar burimin e fondeve buxhetore dhe shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike. Kjo është paraqitur në tabelat e mëposhtme:

Tabela 1. Burimet e fondeve buxhetore - shpenzimi kundrejt buxhetit (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2014 Realizimi	2013 Realizimi	2012 Realizimi
Burimet e Fondeve:	1,095,610	1,035,799	819,206	749,747	638,270
Granti i Qeverisë -Buxheti	1,095,610	1,022,224	819,206	738,988	625,390
Donacionet e Jashtme	0.00	13,575	0.00	10,759	12,880

Si rrjedhojë e shkurtimit të buxhetit me vendimet e Qeverisë, buxheti final ishte reduktuar për 59,811€. Në vitin 2014, IAP ka shpenzuar 79% të buxhet final ose 819,206€, më një nën shpenzim prej 3% krahasuar me vitin 2013.

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike-shpenzimi ndaj buxhetit (€)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2014 Realizimi	2013 Realizimi	2012 Realizimi
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike:	1,095,610	1,035,799	819,206	749,747	638,270
Pagat dhe Mëditjet	596,371	596,371	542,558	450,249	372,940
Mallrat dhe Shërbimet	459,239	403,928	252,779	267,658	246,616
Shërbimet komunale	30,000	25,500	14,724	17,410	18,714
Investimet Kapitale	10,000	10,000	9,145	14,430	-

Shpjegimet rreth ndryshimeve në kategoritë buxhetore janë dhënë si në vijim:

- Në raport me buxhetin fillestar, buxheti final te pagat dhe mëditjet nuk kishte ndryshime. Gjatë vitit 2014 një pjesë e tij, rreth 9% kishte mbetur e pashfrytëzuar si pasojë e mos plotësimit të pozitave të parapara. Arsyet për mos rekrutimin e të gjitha pozitave, ndërlidhën më mungesën e amandamentimit të Ligjit për Avokatin e Popullit (i cili parasheh edhe pozita të reja), si dhe mungesa e hapësirave për akomodimin e stafit;
- Buxheti për mallra dhe shërbime ishte reduktuar për 55,311€. Fillimisht buxheti ishte rritur si rezultat i donacioneve të jashtme për 13,575€, mirëpo më pas ishte reduktuar si rrjedhojë e vendimit të qeverisë për shkurtime buxhetore për 15%. Edhe përkundër reduktimit të buxhetit, 151,149€ ose 37% e tyre kishin mbetur të pashfrytëzuara;

- Reduktimi i buxhetit final ka përfshirë edhe shërbimet komunale për 4,500€ si rrjedhojë e vendimit të Qeverisë për shkurtrim të buxhetit për 15%. Mirëpo edhe përpos kësaj 10,776€, ose 42% kishin mbetur të pashfrytëzuara; dhe
 - Ndërsa, të investimet kapitale nuk kishte ndryshime në mes të buxhetit final dhe atij fillestar si dhe kishte një realizim mbi 91%.
-

Çështja 2 - Planifikim dhe realizim jo i mirë i buxhetit - Prioritet i lartë

E gjetura

Niveli i ulët i realizimit të buxhetit për mallrat dhe shërbimet si dhe komunalit, tregon se planifikimi nuk është bazuar në analiza dhe llogaritje paraprake. Në vijim kemi shpalosur disa raste në të cilat kishte dallime të mëdha në mes të planifikimit dhe realizimit:

- Buxheti për shërbimet e arsimit dhe trajnimit ishte 27,000€, ndërsa janë shpenzuar vetëm 12,539€;
- Buxheti për pajisje tjera ishte 13,000€, ndërsa janë shpenzuar vetëm 2,568€;
- Buxheti për kompjuter dhe hardver për teknologji informative ishte 7,500€, mirëpo gjatë vitit 2014 as nuk kishte filluar të shpenzohet; dhe
- Për shërbimet për anëtarësim ishin buxhetuar 6,000€, mirëpo vetëm 2,500€ ishin shpenzuar.
- Për mirëmbajtjen e teknologjisë informative ishin buxhetuar 3,000€, mirëpo janë shpenzuar vetëm 769€.

Ndryshime në mes të planifikimit dhe realizimit kishte edhe në planin e prokurimit. Për "Botimin e materialit dhe raporteve" vlera e parashikuar ishte 22,000€, mirëpo me rastin e inicimit të kërkesës për prokurim është ndryshuar vlera parashikuar e kontratës në 10,000€.

Rreziku

Planifikimi jo i mirë i buxhetit ndikon në shfrytëzimin jo efikas të burimeve në dispozicion si dhe mos arritjen e objektivave të organizatës.

Rekomandimi 2

Avokati i Popullit duhet të siguroj se përgatitja e buxhetit të paraprihet nga analiza që pasqyron të gjitha informatat relevante, përfshirë realizimet e vitit paraprak dhe ndryshimet e pritura gjatë vitit në vijim. Me tutje, performanca buxhetore duhet të monitorohet në baza të rregullta mujore.

4.2 Shpenzimet

4.2.1 Prokurimi

Përshkrimi

Rregullat e prokurimit kanë për qëllim të sigurojnë se fondet publike arrijnë vlerën për para përmes aplikimit transparent dhe efikas të tyre. Korniza ligjore përcakton qartë të drejtat, detyrat dhe përgjegjësitë e të gjitha palëve të përfshira në prokurimin publik.

Ne testuam shtatë nga 19 kontratat e realizuara gjatë vitit 2014, për të rishikuar nëse të gjitha blerjet janë bërë në pajtueshmëri me kërkesat e Legjislacionit.

Bazuar në këtë ne kemi identifikuar çështjet si në vijim.

Çështja 3 - Pranimi i mallrave para zotimit të mjeteve si dhe anashkalimi i kërkesave të përcaktuara më rregulla të thesarit gjatë procesimit të pagesave - Prioritet i mesëm

E gjetura Sipas rregullave të Thesarit, fillimisht duhet të bëhet kërkesa për blerje, zotimi i mjeteve, procedohet urdhërblerja, pastaj të pranohet malli apo shërbimi, dhe pas pranimi të faturës të ekzekutohet pagesa në fjalë.

Në katër pagesa nga kategoria e mallrave dhe shërbimeve vërejtëm se zotimi, kërkesa për blerje dhe urdhërblerja ishin bërë me vonesë, përkatësisht pas pranimi faturës.

Rreziku Hyrja në obligime pa siguruar fondet e nevojshme do të rezultojë në vonesa të implementimit të kontratës dhe rritjen e obligimeve të papaguara, të cilat do të jenë barrë për buxhetin e vitit vijues. Ndërsa, kryerja e pagesave për mallra dhe shërbime para se të përcaktohen kërkesat/nevojat, mund të rezultojë që të pranohen mallra të cilësisë dhe sasisë jo të nevojshme.

Rekomandimi 3 Avokati i Popullit duhet të sigurojë implementimin e kontroleve efektive që kontratat të nënshkruhen vetëm atëherë kur ekzistojnë fonde që sigurojnë ekzekutimin e kontratës. Gjithashtu duhet forcuar kontrollet në procesin e ekzekutimit të pagesave. Procesi i pagesave duhet të bëhet në pajtim të plotë me hapat e përcaktuar me LMFPN-në, dhe me rregullat e Thesarit.

Çështja 4 - Vonesa në ekzekutimin e pagesave - Prioritet i mesëm

E gjetura IAP nuk ka arritur të kryejë pagesat në afatin e përcaktuar ligjor. Në vijim kemi shpalosur katër raste në të cilat kishte vonesa në ekzekutimin e pagesave:

- Fatura në vlerë 928€, për “Sigurimin e ndërtesave për nevojat e IAP-së” është ekzekutuar me 46 ditë vonesë;
- Fatura në vlerë 228€, për “Furnizime për zyre” është ekzekutuar me 30 ditë vonesë;
- Fatura në vlerë 2,034€, për “Shërbimet kontraktuale tjera” është ekzekutuar me 23 ditë vonesë; dhe
- Fatura në vlerë 170€, për “Shpenzimet për akomodime” është ekzekutuar me 28 ditë vonesë.

Zyrtarët e financave nuk kanë arritur të arsyetojnë vonesat në ekzekutimin e pagesave. Shkaqet e vonesave vijnë si pasojë e neglizhencës në procesimin e tyre.

Rreziku Vonesat në ekzekutimin e pagesave rrisin rrezikun për pagesa shtesë të dëmshpërblimeve ndaj Operatorit Ekonomik (OE). Gjithashtu, ekziston rreziku për dështimin e pagesave në vitin aktual dhe bartjen e tyre si obligime në vitin pasues.

Rekomandimi 4 Avokati i Popullit duhet të siguroj mbikëqyrje të rregullt të procesit të ekzekutimit të buxhetit, me qëllim që çdo faturë të paguhet brenda afatit të përcaktuar ligjor.

Çështja 5 - Furnizimi me mallra pas skadimit të kontratës - Prioritet i mesëm

E gjetura Furnizimi “Material shpenzues për zyre” në vlerë 228€ është realizuar pas skadimit të kontratës. Kontrata me OE ka përfunduar me 24 mars 2014, ndërsa furnizimi është realizuar me 8 maj.

Pagesat e kryera në mungesë të dëshmive të përcaktuara më Legjislacion konsiderohen të parregullta. Procesi i certifikimit nuk ka arritur të parandaloj pagesat e tilla.

Rreziku Furnizimi pas skadimit të marrëveshjeve kontraktuale, rritë rrezikun e furnizimit me mallra ose shërbime jashtë kriterëve dhe specifikave të kërkuara.

Rekomandimi 5 Avokati i Popullit duhet të siguroj kontrolle shtesë në procesin e ekzekutimit të pagesave, e kryesisht në fazën e certifikimit, në mënyrë që të parandalohen të gjitha pagesat e parregullta.

4.2.2 Shpenzimet tjera

Përshkrimi

Në kategorinë e shpenzimeve tjera për të cilat nuk nevojitet të zhvillohen procedura të prokurimit, ne kemi testuar katër pagesa në vlerë 7,135€. Në këtë kategori janë përfshirë shpenzimet lidhur me shpenzimet e qirasë, shpenzimet e rrymës dhe avanset për udhëtime zyrtare.

Gjatë testimit të tyre nuk kemi hasur në ndonjë mangësi për tu raportuar.

Rekomandimi

Ne nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

4.2.3 Kompensimet (pagat dhe mëditjet)

Përshkrimi

Pagat dhe Mëditjet paguhen përmes një sistemi të centralizuar qeveritar. Kontrollat që operojnë në nivel të IAP-së kanë të bëjnë me kontrollin e pagesave çdo muaj duke i nënshkruar listat e pagave, verifikimin e ndryshimeve të mundshme që mund të paraqiten përmes formularëve, rishikimin e buxhetit për këtë kategori dhe barazimet me Thesarin.

Në kuadër të kësaj kategorie, ne kemi testuar sistemin e kontrollit, përfshirë procesin nga përgatitja e listave të pagave deri në ekzekutimin dhe raportimin e tyre. Gjithashtu ne kemi testuar edhe proceset e rekrutimit dhe mirëmbajtjen e dosjeve të personelit.

Bazuar në këtë ne konkludojmë se IAP kishte vendosur kontrole të mira në procesimin e pagave për pagesë si dhe në mirëmbajtjen e dosjeve të personelit.

Rekomandimi

Ne nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

4.3 Pasuritë dhe obligimet

4.3.1 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale

Përshkrimi

Menaxhimi i pasurisë është një pjesë e rëndësishme e menaxhimit financiar dhe kontrollit në sektorin publik. Kjo kërkon procedura të kontrollit dhe menaxhimit të cilat të vërtetojnë ekzistencën e pasurive ekzistuese dhe sigurojnë të dhëna të azhurnuara në përputhje me pasuritë e reja dhe ndryshimet e tjera.

Pasuritë me vlerë mbi 1,000€ të IAP-së ishin 21,982€, pasuritë nën 1,000€ ishin 12,000€, si dhe stoqet 21,000€.

Ne kemi testuar disa pagesa që kanë të bëjnë me blerje të reja të pasurive (mbi 1,000€), si dhe kemi kryer teste tjera për të verifikuar nëse pasuritë janë mbajtur në pajtueshmëri me kërkesat e Rregullores nr.02/2013, për menaxhimin e pasurisë jo financiare të organizatave buxhetore.

Gjithashtu ne kemi kryer një ekzaminim fizik të pasurisë për të verifikuar ekzistencën e tyre.

Rekomandimi

Ne nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

4.3.2 Trajtimi i obligimeve

Përshkrimi

Në fund të vitit 2014, obligimet e papaguara të IAP-së ishin në vlerë 1,450€, që krahasuar me vitin 2013 janë rritur për 924€. Megjithatë, vlera e obligimeve të mbetura në fund të vitit është e ulët.

Ne kemi testuar mënyrën e evidentimit dhe raportimit të tyre dhe kemi bërë teste substanciale në disa raporte.

Bazuar në këtë konkludojmë se IAP kishte arritur të dorëzojnë raporte të rregullta në MF, megjithëse cilësia e raporteve të tyre nuk ishin të besueshme.

Çështja 6 - Raportim jo i saktë në raportet mujore të obligimeve - Prioritet i mesëm

- E gjetura** Raportet e obligimeve të papaguara për periudhën janar – prill 2014, ishin të raportuara me zero. Ndërsa në raportin e obligimeve të muajit maj 2014, ishin përfshirë edhe disa fatura të pranuar në muajin prill në vlerë 1,098€.
- Zyrtarët e financave nuk e kishin të qartë mënyrën e raportimit të obligimeve të papaguara. Ata kanë paraqitur vetëm obligimet e vonuara për pagesë (faturat të cilat kanë kaluar afatin prej 30 ditësh nga data e pranimit). Gjithashtu nuk kanë përcjellë gjendjen e obligimeve nga muaji paraprak në muajin vijues.
- Rreziku** Mos raportimi i plotë dhe i saktë i obligimeve krijon rrezikun për ekzekutimin e pagesave të dyfishta ose në mos pagesë të obligimeve ndaj kontraktuesve.
- Rekomandimi 6** Avokati i Popullit duhet të ndërmerr veprimet e nevojshme për të identifikuar shkaqet e mos raportimit të drejt të obligimeve të papaguara, dhe të sigurojë se raportimi i tyre bëhet në përputhje me kërkesat. Të gjitha faturat e papaguara duhet të përfshihen në raportin mujor të obligimeve dhe vlera e tyre duhet të përcjellët deri në pagesën e tyre.

4.4 Sistemi i auditimit të brendshëm

Përshkrimi

NJAB është themeluar nga fundi i vitit 2013. Kjo njësi është funksionale dhe ka operuar në bazë të planit dhe përgjegjësi të caktuara.

Plani ishte hartuar bazuar në vlerësimin e rrezikut dhe prioritetëve. Sipas tij janë paraparë të kryhen shtatë auditime të cilat kanë mbuluar financat, prokurimin logjistikë etj.

NJAB, gjatë vitit 2014 kishin përmbushur në tërësi planin e auditimit. Ato i ofruan menaxhmentit një pasqyrë të qartë mbi nivelin e sigurisë së kontrolleve të brendshme dhe efektivitetin e tyre.

Nga 29 rekomandimet e dhëna të NJAB-ve, 14 ishin adresuar plotësisht, 14 ishin në proces të adresimit dhe një nuk është adresuar.

Po ashtu NJAB kishte raportuar në Njësinë Qendrore Harmonizuese për vitin 2014.

Rekomandimi

Ne nuk kemi rekomandime në këtë fushë

Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZAP

(e shkëputur nga ISSAI 200)

Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë anomali materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë anomali materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për 'Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit'.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornizë për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinion në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë anomali materiale. Auditorët mund të japin tre lloje opinionesh të modifikuara: opinion të kualifikuar, opinion të kundërt dhe mohim të opinionit.

Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- Natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse pasqyrat financiare përmbajnë anomali materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë anomali materiale; dhe
- Gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në pasqyrat financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se anomalitë, ose individualisht ose së bashku, janë materiale por nuk përhapen në pasqyrat financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare mund të jenë materiale por nuk përhapen.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se anomalitë, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe përhapen në pasqyrat financiare.

155. Auditori duhet japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare mund të jenë edhe materiale edhe të përhapen. Nëse, pas pranimit të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinionit mbi pasqyrat financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

156. Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 1705 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban anomali materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragrafi të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

158. Një paragraf i Theksimit të Çështjes duhet:

- Të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- Të ketë titullin 'Theksim i Çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- Të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç' pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen;
- Të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.

Shtojca II: Rekomandimet e vitit paraprak

Komponenta e Auditimit	Rekomandimet e dhëna	Rekomandimet plotësisht të adresuara	Rekomandimet pjesërisht të adresuara	Rekomandimet e pa adresuara
3. Rekomandimet e vitit paraprak	Avokati i Popullit duhet të sigurojë se plani i veprimit përcakton qartë një afat kohor për adresimin e rekomandimeve me anëtarë të stafit përgjegjës të identifikuar, dhe me fokus fillestar në fushat e rëndësisë më të madhe. Implementimi i këtij plani duhet të rishikohet nga Menaxhmenti në baza të rregullta.		Menaxhmenti kishte përgatitur planin për adresimin e rekomandimeve dhe kishte adresuar rekomandimin për shërbimet e telefonisë. Mirëpo edhe më tutje edhe katër rekomandime mbetën të pa adresuara.	
4.2. Planifikimi dhe realizimi buxhetit	Avokati i Popullit duhet të siguroj se përgatitja e buxhetit paraprihet nga një proces rigoroz i vlerësimit që pasqyron të gjitha informatat relevante përfshirë realizimet e vitit paraprak dhe ndryshimet e pritura gjatë vitit. Performanca buxhetore të monitorohet në baza mujore dhe barrierat e identifikuara për nivelet e ekzekutimit buxhetor të adresohen me kohë.			Nuk është adresuar.
4.3. Donacionet e jashtme	Avokati i Popullit duhet të siguroj se me rastin e hartimit të planit buxhetor, fondet buxhetore nga donacionet janë të harmonizuara me koston e përafërt të projekteve, si dhe të bëhet një plan i qartë kohor për fillimin e shfrytëzimit të tyre.			Nuk është adresuar.

4.4.1. Prokurimi	Avokati i Popullit duhet të siguroj se do të bëhet një plan prokurimi i cili specifikon qartë kërkesat për mallrat dhe shërbimet. Bazuar në këtë plan për të gjitha blerjet mbi vlerën 10,000€, të cilat planifikohen të realizohen brenda vitit, të aplikohen procedurat e hapura të prokurimit.			Nuk është adresuar.
4.4.1. Prokurimi	Avokati i Popullit duhet të shqyrtojë pse faturat nuk janë paguar brenda afatit të parashikuar dhe të ushtrojë më shumë kontrole për të siguruar që të gjitha faturat procesohen me kohë për pagesë.			Nuk është adresuar.
4.4.2. Shpenzimet jo përmes prokurimit	Avokati i Popullit duhet të shqyrtojë mundësinë që përmes procesit të rregullt të prokurimit të kontraktoshërbimet e telefonit. Kjo do të siguroj shërbime me cilësore me kosto më të ulët.	Po		